



ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania




NEWSLETTER

PRILL - QERSHOR 2022



Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve



RRETH NESH

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve boton numrin e dytë të revistës për vitin 2022, për periudhën prill-qershor.

AIDA ka kthyer në traditë botimin e revistës periodike tremujore. Çdo vit, Agjencia publikon 4 numra të newsletter-it me informacione të vlefshme për audiencën, grupet e interesit, bizneset dhe publikun më të gjerë. Në formatin e një buletini elektronik, ndarë në disa rubrika, revista pasqyron evente, takime, webinare, sesione informuese/info day, door to door, aftercare, trajnime, vizita, forume, panaire, bashkëpunime, botime e publikime, përditësime dhe informacione të rëndësishme mbi sipërmarrjen, nisma apo fushata të rëndësishme që AIDA ndërmerr.

Secili nga numrat e revistës elektronike është njëherësh një dokumentim që përmbledh aktivitetet përgjatë 3 muajve dhe një burim informacioni, që shfaq profilin e konsoliduar të AIDA-s dhe fushave që ka në fokus.

AIDA zhvillon veprimtarinë e saj për të fuqizuar zhvillimin ekonomik të vendit, sidomos duke përkrahur prodhuesit dhe produktet vendase. Në funksion të një diplomacie ekonomike, Agjencia jep kontribut në zgjerimin e bashkëpunimit me vende partnere dhe strategjike nëpërmjet dialogut me institucione që kanë në fokus investimet, si dhe rolit aktiv dhe pjesëmarrjes së vazhdueshme në evente që kanë si objektiv promovimin e Shqipërisë në fusha të ndryshme.

Mbështetja dhe asistimi profesional i investitorëve të huaj mbeten me prioritet të veçantë. Agjencia, përveç tërheqjes së investimeve direkte në vendin tonë, ndërmerr nisma për rritjen e konkurrencës mes Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), zhvillimin e sektorit privat, përmirësimin e klimës së biznesit, për promovimin dhe ofrimin e ndihmës për eksportet e mallrave dhe shërbimeve, duke bashkëpunuar me subjektet e tregtisë së jashtme dhe organet shtetërore.

Në ndihmë të bizneseve vendase dhe produkteve 'Made in Albania', AIDA vijon fushatën promovuese 'E Dua Shqip'.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve është proaktive dhe ka si përparësi mbështetjen e interesave ekonomike të Shqipërisë, tërheqjen e investimeve të huaja, promovimin e vendit si destinacion i veçantë dhe i qëndrueshëm turistik, si partner i besuar tregtar/i investimeve të huaja në sektorë potencialë si energjia, turizmi, infrastruktura, bujqësia etj., si dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të markës shqiptare.



FUSHATA PROMOVUESE DHE PROJEKTE

- > FUSHATA PROMOVUESE “ZGJITH TË VENDIT”
- > PLATFORMA AKSES NË FINANCË
- > PLATFORMA “BUSINESS TO BUSINESS”



FUSHATA PROMOVUESE E PRODUKTEVE SHQIPTARE “ZGJIDH TË VENDIT”

AIDA, si një pikë qendrore për sipërmarrjen është gjithmonë në mbështetje të prodhuesve shqiptarë, të cilët gjithnjë e më shumë po shtojnë produkte nën markën “Made in Albania”, duke ofruar për tregun vendas dhe atë të huaj cilësinë dhe vlerat tona tradicionale. E Dua Shqip është fushata promovuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve/AIDA në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve ‘Made in Albania’. Qëllimi ynë është të njohim, zgjedhim dhe duam çdo ditë produktet shqiptare. T’i japim jetë artizanatit, produkteve autentike dhe unike duke bërë bashkë çdo copëz që ndërton historinë e Shqipërisë me vlera. Kjo nismë synon të krijojë një katalog sa më të plotë dhe gjithëpërfshirës. Nëse jeni një biznes apo artizan, prodhoni të mira nga duart tuaja, doni t’i prezantoni dhe

t’i ktheni në një “atraksion turistik” për vendin e origjinës, na dërgoni përshkrimin dhe fotografitë e produktit. Rrënjët janë të rëndësishme. Nëse dëshironi të bëheni pjesë e kësaj fushate, na kontaktoni në info@aida.gov.al ose në numrin e telefonit 04 225 1001.



[Kliko këtu për listën e plotë të produkteve](#)



AKSES NË FINANCË, PLATFORMA UNIKE PËR FINANCIMIN E BIZNESEVE

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve mirëmban dhe përditëson me skema të reja financiare platformën "Akses në Financë", duke ofruar informacionin më të fundit mbi mundësitë dhe burimet financiare për NVM-të në Shqipëri. AIDA kujdeset, që thirrjet e publikuara në plat-

formë <https://aida-smefinance.gov.al/> të përmbajnë të dhënat thelbësore dhe të jenë shteruese në përcjelljen e informacionit, për të orientuar një aplikim të suksesshëm dhe për të përmbushur në këtë mënyrë misionin për mbështetjen e biznesit vendas...[\(lexo më shumë\)](#)



PLATFORMA "BUSINESS TO BUSINESS"

Në web faqen e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) është e publikuar platforma "Business to Business", (B2B) që ju vjen në ndihmë NVM që veprojnë në Shqipëri.

B2B është një rrjet aktiv, i cili ofron mundësinë për bashkëpunime dhe investime të suksesshme midis bizneseve. Kjo platformë është një "me-

kanizëm" lehtësues që krijon mundësi për bashkëpunime frytdhënëse dhe për të zgjeruar kontaktet në botën e biznesit.

AIDA, ju fton të regjistroheni ose përditësoni të dhënat tuaja në platformën B2B, duke na kontaktuar në adresën zyrtare: info@aida.gov.al ... [\(Lexo më shumë\)](#)



INVESTIMET STRATEGJIKE DHE TË HUAJA NË SHQIPËRI

AIDA vizitë në bizneset “KT Fier” dhe “Turtextil” në Fier



AIDA, e përfaqësuar nga stafi i sektorit të Investimeve & AfterCare, vijon fushatën e takimeve me biznesin, në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm të shërbimeve të sektorit AfterCare, duke theksuar rëndësinë që ato kanë në krijimin e një klime të favorshme për rritjen dhe zgjerimin e investimeve në nivel lokal.

Në datën 20 maj 2022, AIDA vizitoi ambientet e dy kompanive “KT Fier” dhe “Tur-Tekstil”, të cilat operojnë në qarkun e Fierit. Gjatë takimit, u diskutuan nevojat dhe problematikat e ndryshme që këto biznese kenë hasur në aktivitetin e tyre; [...\(lexo më shumë\)](#)

AIDA viziton shkollën e mesme profesionale “Petro Sota”



Në datën 20 maj 2022, përfaqësues të stafit të sektorit të Investimeve & Aftercare, zhvilluan një takim në Shkollën e Mesme Profesionale “Petro Sota”, në qytetin e Fierit. Takime të tilla shfaqin edhe njëherë, rëndësinë që agjencia u kushton shkollave profesionale, si elemente kyç në zhvillimin e biznesit në nivel lokal. Aktualisht, në shkollën “Petro Sota”, ndjekin studimet rreth 650 nxënës, të cilët do të profilizohen në fusha/profesionet e ndryshme, si p.sh.: shërbime mjeteshe transporti; elektro-teknikë; mekanikë, teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK), etj. [...\(lexo më shumë\)](#)



Kompania indiane "Rajdhani", ka shprehur interes për të vendosur kontakte bashkëpunimi me kompani shqiptare që importojnë grurë dhe produkte të tjera si: miell gruri, makarona, bishtaja të përpunuara etj. Kompania "Rajdhani" operon në 20 vende të botës. Ajo merret me prodhimin, paketimin dhe tregtimin e një game të gjerë artikujsh ushqimorë, nën emrin e markës së saj.

Kompania është e akredituar me certifikatën gjermane ISO 22000-2005, por dhe me certifikata të tjera nga organizatat e Qeverisë së Indisë. Gjithashtu, kjo kompani është importuesi kryesor i drithërave nga Australia, Etiopia, Kanadaja, Mianmari dhe Kina. Për më shumë informacion mbi kompaninë dhe produktet e saj, vizitoni faqen: <http://rajdhanigroup.com/>



AIDA NË NDIHMË TË NDËRMARRJEVE MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME (NMVM)

Nisma “Për zhvillimin e tregtisë elektronike”



Në vitin 2021, AIDA në bashkëpunim me Bankën Botërore, ndërmori nismën “Për zhvillimin e Tregtisë Elektronike”, duke e vijuar edhe këtë vit. Gjatë kësaj nisme u zhvilluan disa takime me Bankën Botërore, për përgatitjen e guidës udhëzuese “Si të Nisësh një Biznes e-commerce”, në ndihmë të sipërmarrjeve dhe palëve të interesuara në zhvillimin e tregtisë elektronike. Për të kuptuar më mirë NMVM-të në Shqipëri, AIDA përgatiti gjithashtu edhe pyetësinorin ...[\(lexo më shumë\)](#)

Aktiviteti “Si të Nisësh një Biznes e-commerce”



AIDA organizoi aktivitetin online me bizneset shqiptare ku prezantoi udhëzuesin “Si të Nisësh një Biznes e-commerce”.

Për të ndjekur videon e takimit:

<https://www.facebook.com/watch/?v=1189802781819385>


Për t’u njohur më gjerësisht me udhëzuesin, klikoni në linkun: <https://aida.gov.al/e-commerce>.

Seminare informuese mbi tregtinë elektronike



AIDA, në vazhdimësi të fushatës ndërgjegjësuere për ngritjen e kapaciteteve dhe aplikimin e tregtisë elektronike, zhvilloi ciklin e seminareve informuese me institucionet publike dhe dhomat e tregtisë. Gjatë këtij cikli u prezantua udhëzuesi “Si të Nisësh një Biznes e-commerce” në ndihmë të sipërmarrjeve dhe palëve të interesuara në zhvillimin e tregtisë elektronike.

Regional challenge fund in the Western Balkan 6



AIDA, njofton se është hapur thirrja: “Regional Challenge Fund in the Western Balkan 6”. Qëllimi i thirrjes është rritja e konkurrueshmërinë së sipërmarrjeve në 6 ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, duke financuar investime në pajisje dhe infrastrukturë për projekte të përzgjedhura për bashkëpunime ose trajnime përmes partneriteteve midis institucioneve të formimit profesional dhe sipërmarrjeve...[\(lexo më shumë\)](#)

Skilling up the western balkans agri-food sector



AIDA, njofton se Fondacioni Europian i Trajnimeve (ETF), ka lançuar projektin: “Skilling up the Western Balkans agri-food sector: greening, digitalising”. Projekti do të trajtojë nevojat për aftësim në sektorin agro-ushqimor, si një sektor prioritar në rajonin e Ballkanit Perëndimor...[\(lexo më shumë\)](#)

Create the future of skills in agri-food”



AIDA, njoftoi se Fondacioni Europian i Trajnimeve (ETF), ka lançuar projektin “Create the future of skills in Agri-Food”. Ky projekt do të adresojë nevojat për aftësim në sektorin agro-ushqimor, si një sektor prioritar në rajonin e Ballkanit Perëndimor...[\(lexo më shumë\)](#)

AIDA NË NDIHMË TË NDËRMARRJEVE MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME (NMVM)

Pyetësi i eksporteve

Gjendja e tregtisë elektronike
(e-commerce) në ndërmarrjet
mikro, të vogla dhe të mesme



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në vijim të punës për hartimin e Strategjisë së Eksporteve, realizoi plotësimin e “Pyetësit të Eksporteve”, me qëllim identifikimin e masave dhe shërbimeve, në dispozicion të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), si dhe në mbështetje të aktiviteteve të tyre eksportuese dhe të ndërkombëtarizimit.

Pyetësi synonte vlerësimin e situatës aktuale të kompanive eksportuese shqiptare dhe pasqyrimin e nevojave dhe kërkesave të tyre, në mënyrë sa më të qartë në “Programin për Nxitjen e Eksporteve dhe Ndërkombëtarizimin 2022-2027” ...[\(lexo më shumë\)](#)

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në kuadër të nismës “Për Zhvillimin e Tregtisë Elektronike”, në bashkëpunim me Bankën Botërore, përgatiti pyetësin “Gjendja e tregtisë elektronike (e-commerce) në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)”.

Rezultatet e këtij pyetësi do të shërbejnë për të përcaktuar nevojat dhe për të vlerësuar gjendjen e NMVM-ve, lidhur me zhvillimin e tregtisë elektronike.

Njihuni me rezultatet e pyetësit duke klikuar [këtu](#).



TAKIME DYPALËSHE

Takim me ambasadorin e Egjiptit në shqipëri, sh.t. z. Mohamed Mustafa Heider



Drejtori ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano, priti në takim Ambasadorin e Egjiptit në Shqipëri, Z. Mohamed Mustafa Heider. Ambasadori shprehu vlerësimin e tij për Shqipërinë dhe mundësitë që ajo ofron për investime në sektorë të ndryshëm nga subjektet egjiptiane.

Z. Nano prezantoi sektorët prioritarë për investim nga kompanitë egjiptiane, ndër të cilët mund të përmendim sektorin e energjisë së rinovueshme, bujqësisë dhe turizimit. Ky takim i hap rrugë bashkëpunimit për realizimin e projekteve konkrete në sektorët e diskutuar...[\(lexo më shumë\)](#)

Takim me ambasadorin e japonisë Sh. T. Z. Takada Mitsuyuki



Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, priti në takim Ambasadorin e Republikës së Japonisë në Shqipëri Sh. T., Z. Takada Mitsuyuki.

Në takim u diskutuan aktivitetet që do të mbahen në kuadër të kremtimit të 100-vjetorit të marrëdhënieve diplomatike Japoni- Shqipëri. Sh. T., Z. Mitsuyuki, shprehu gjithashtu edhe interesin e shfaqur nga kompanitë japoneze për të bërë biznes në Shqipëri në sektorin e energjitikës, bujqësisë dhe sigurisë së informacionit.

Një pikë tjetër e rëndësishme e diskutimit ishte dhe pjesëmarrja e Shqipërisë në panairin ndërkombëtar Expo Osaka 2025...[\(lexo më shumë\)](#)

Takim me ambasadorin e Republikës së Serbisë në Shqipëri



Drejtori Ekzekutiv i AIDA, Z. Sokol Nano, priti në një takim Ambasadorin e Republikës së Serbisë në Shqipëri, Z. Slobodan Vukcevc dhe Ministrin Këshilltar, Z. Dejan Hinic.

Gjatë takimit palët diskutuan mbi marrëdhëniet mëse të mira dhe mundësitë e zhvillimit ekonomik të ndërsjelltë, si dy vende të Ballkanit Perëndimor... [\(lexo më shumë\)](#)

Vizitë zyrtare e AIDA-s në zyrën për investime të presidencës Turke



Drejtori i AIDA-s, Z. Sokol Nano, zhvilloi një vizitë dy ditore në Stamboll, me ftesë të homologut të tij Z. Burak Daghoglu, President i Zyrës së Investimeve të Presidencës Turke.

Të dy agjencitë kanë filluar tashmë punën e përbashkët për të hartuar propozimet konkrete të investimeve në sektorët e identifikuar me interes për kompanitë turke... [\(lexo më shumë\)](#)

Marrëveshje bashkëpunimi: AIDA nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Dhomën e Tregtisë Zviceriane Shqiptare



Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano, priti në takim Presidentin e Dhomës së Tregtisë Zviceriane Shqiptare (SWISSA), Z. Samir Shqarri. Gjatë takimit, u diskutua mbi mundësitë për bashkëpunim mes palëve, me qëllim prezantimin e Shqipërisë si një destinacion investimesh për kompanitë zviceriane. Përveç kësaj u fol edhe rreth shërbimeve që AIDA of-



ron për kompanitë e huaja. Gjithashtu, palët ranë dakord për organizimin e disa aktiviteteve të përbashkëta në vijim.

Në përfundim të takimit, palët nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi, e cila i hap rrugën intensifikimit të marrëdhënieve mes dy institucioneve.



AKTIVITETE DHE PANAIRE

SHQIPËRIA PËRFAQËSOHET NË PANAIRIN BIOFACH 2022, ME 5 KOM- PANI TË SEKTORIT TË BIMËVE MEDICINALE DHE AROMATIKE



Shqipëria do të marrë pjesë në panairin BIOFACH 2022 me pavionin e saj të organizuar nga AIDA dhe me mbështetjen e SIPPO Albania.

AIDA në bashkëpunim me SIPPO Albania, organizon Pavijonin e Shqipërisë në një nga panairët më të mëdhenj të ushqimit organik dhe bimëve aromatike dhe medicinale, BIOFACH 2022, i cili do të mbahet në Nuremberg, Gjermani, në datat 26 – 29 Korrik 2022.

\=

AIDA së bashku me SIPPO Albania kanë filluar përgatitjet për panairin "BIOFACH 2022". Në pavijonin e Shqipërisë, i cili do të gjen-

det në korridorin 4A – 238, do të ekspozohen bimë aromatike dhe medicinale nga 5 kompani Shqiptare pjesëmarrëse në panair.

Në vijim të fazës përgatitore, AIDA dhe SIPPO Albania kanë organizuar një sesion përgatitor për stafin pjesëmarrës në panair, duke vazhduar me vizitat në secilën kompani që do të marrë pjesë në event, me qëllim zgjerimin e aktivitetit në tregje të huaja të kompanive shqiptare në Sektorin e Bimëve Medicinale & Aromatike.

Vizitat u zhvilluan në kompanitë: BIOBES, BIDAJ sh.p.k, "Vasil Mama & Co", "Çibuku sh.p.k".

Kompania BIOBES në BIOFACH



Gjatë panairit BIOFACH 2020, kompania "BIOBES" lidhi disa kontrata të reja, ndaj edhe këtë vit do të jetë pjesë e Pavijonit të Shqipërisë, duke ofruar një gamë të gjerë produktesh si: sherbela, kalendula dhe "Lemon Verbena Luiza".

Kompania BIDAJ në BIOFACH



Gjatë edicionit të kaluar të BIOFACH, kompania "BIDAJ sh.p.k" ishte pjesë e Pavijonit të Shqipërisë dhe nënshkroi me sukses disa marrëveshje eksporti. Këtë vit, kompania do të prezantohet në panair me stendën e saj.

"Vasil Mama & Co" në BIOACH



"Vasil Mama & Co" është themeluar në vitin 2016 dhe ka filluar aktivitetin me kultivimin e bimëve medicinale aromatike organike, si dhe me mbledhjen, përpunimin dhe eksportimin e bimëve spontane. Këtë vit, kompania do të jetë pjesë e Pavijonit të Shqipërisë për herë të parë në panairin BIOFACH 2022.

"Çibuku sh.p.k" në BIOFACH



"Çibuku sh.p.k" do të jetë pjesë e Pavijonit të Shqipërisë për herë të parë në panairin BIOFACH 2022. Është lider në grumbullimin, përzgjedhjen, pastrimin, përpunimin dhe eksportin e bimëve aromatike-mjekësore. Kompania ka një rrjet të përbërë nga 300 kultivues dhe mbledhës të bimëve, më së shumti të gjendura rreth qarkut të Korçës, aty ku dhe vetë kompania operon.



NEW ERA OF EXHIBITION

Në muajin maj, u zhvillua Panairi Ndërkombëtar i Bujqësisë, Teknologjive, Ushqimit dhe Përpunimit, në qytetin e Lushnjës. Qëllimi kryesor i panairit ishte krijimi i një platforme komunikimi për sipërmarrjet me qëllim sigurimin e informacionit mbi tendencat e reja dhe zhvillimet teknologjike të sektorit, nxitjen e partneriteteve të reja, rritjen e forcimit të bashkëpunimeve mes bizneseve dhe institucioneve në sektorin e bujqësisë.

AIDA mori pjesë në panair me standin e saj, me qëllim promovimin e sektorit dhe produkteve Made in Albania, ofrimin e asistencës dhe informacionit mbi sektorin për bizneset dhe palët të interesuara, si dhe organizimin e takimeve për bashkëpunim dhe partneritet mes bizneseve pjesëmarrëse.

Në ditën e parë të pjesëmarrjes AIDA, mbajti gjithashtu edhe një konferencë me temë: "Sektori i Bujqësisë - Inovacioni dhe Investimet në këtë Sektor". Panairi u organizua nga Iceberg Exhibitions, me mbështetjen e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministres së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Në panair morën pjesë agrobiznese dhe aktorë të rëndësishëm të sektorit nga Shqipëria,

Ballkani dhe Evropa. Panairi shërbeu si një mundësi për të gjithë pjesëmarrësit, jo vetëm për të lidhur kontakte me blerës, bashkëpunorë ndërkombëtarë dhe vendas apo ekspertë të sektorit, por edhe për t'u njohur me teknologjitë më të fundit të nevojshme për zhvillimin e biznesit.

Planifikimin operacional i Proseed 2.0



AIDA ishte pjesë e aktivitetit të organizuar në muajin prill nga Programi ProSeed mbi Planifikimin Operacional të ProSEED 2.0, i cili ka hyrë në fazën e zbatimit, nëpërmjet financimit të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ). ProSEED, planifikoi aktivitetet dhe ndërhyrjet kryesore në fushat e zhvillimit të sektorit privat, arsimit dhe formimit profesional, si dhe mbështetjen për zhvillimin ...[\(lexo më shumë\)](#)

Seminar online - Menaxhimi i mbetjeve në hotele dhe struktura akomoduese në Shqipëri

Mbi efikasitetin në energji & menaxhimin e mbetjeve
në Hotele & Struktura Akomoduese

SEMINAR 1 13 PRILL 2022
Menaxhimi i Mbetjeve

SEMINAR 2 20 PRILL 2022
Sistemet Fotovoltaike


AIDA ishte pjesë e ciklit prej katër seminaresh të organizuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në kuadër të zbatimit të "Programit të Turizmit për Zhvillimin Ekonomik Lokal", të financuar nga Bashkimi Evropian (BE). Fokusi i seminareve ishte menaxhimi i mbetjeve, efikasiteti i energjisë (EE) dhe shfrytëzimi i burimeve të rinovueshme të energjisë (RES), në Hotele dhe Struktura Akomoduese në...[\(lexo më shumë\)](#)

Seminar online: Bazat e menaxhimit financiar



AIDA ishte pjesë e një trajnimi katër-ditor, me temë "Bazat e Menaxhimit Financiar", të organizuar nga Këshilla për Bizneset e Vogla (ASB), e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në muajin maj 2022. Fokusi i trajnimit ishte gratë sipërmarrëse të cilat operojnë në sektorin e turizmit dhe agrobiznesit, si dhe sektorë të tjerë prioritarë të ekonomisë.

Workshop: "Mundësitë e investimit në Shqipëri nga vendet e rajonit Adriatiko-Jonian"



Më datë 16 maj, përfaqësues nga AIDA, ishin pjesë e panelit në workshop-in e organizuar në kuadër të Forumit të 7-të të Strategjisë së BE-së për Rajonin Adriatiko-Jonian (EUSAIR). Qëllimi i workshop-it ishte prezantimi i mundësive për investim në Shqipëri nga vendet e rajonit Adriatiko-Jonian...[\(lexo më shumë\)](#)



PUBLIKIMET E REJA TË AIDA-S



Udhëzuesi “Si të nisësh një biznes e-commerce”

Si të nisësh një biznes e-commerce - Ky botim u vjen në ndihmë Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), Startup-eve dhe palëve të interesuara në zhvillimin e tregtisë elektronike. Udhëzuesi përfshin të gjithë hapat e rëndësishëm për planifikimin, dizenjimin dhe zhvillimin e tregtisë elektronike, duke e bërë produktin më të njohur në tregun kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Ju informojmë, se ky udhëzues do të jetë subjekt i përditësimeve periodike për të pasqyruar drejtimet ose tendencat e reja të tregut.

Kliko linkun: <https://aida.gov.al/e-commerce.pdf>

TË TJERA



INFORMACIONE & STATISTIKA


“BIFIDEX” - PLATFORMA E BIZNESIT TË RAJONIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR

BIFIDEX është platforma e përbashkët rajonale e Ballkanit Perëndimor, anëtare e së cilës është edhe regjistri tregtar i administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Në platformë do të gjeni analizimin e të dhënave tregëtare, financiare dhe statutore, të përafërsisht 1.5 milionë shoqërive dhe individëve nga regjistrat zyrtarë të Shqipërisë, Serbisë, Maqedonisë së Veriut,

Malit të Zi dhe Bosnje-Hercegovinës (Republika Srpska). Platforma përçon një informacion të plotë mbi shoqëritë e lidhura dhe degët në të gjithë rajonin.

Klikoni linkun: <https://qkb.gov.al/.../publiki-mi-i-platfomes-se...>





STATISTIKA: Rriten eksportet e mallrave për periudhën Janar – Mars 2022

Sipas INSTAT-it, në këtë tremujor, eksportet e mallrave arritën vlerën 120 mld lekë, duke pësuar një rritje me 49,6 %.

Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +18,5 pikë përqindje, “materiale ndërtimi dhe metale”

me +14,4 pikë përqindje, dhe “tekstile dhe këpucë” me +6,4 pikë përqindje.

Vendet, me të cilët Shqipëria ka patur rritje të eksporteve, gjatë këtij tremujori, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (54,5 %), Kosova (52,0 %) dhe Gjermania (123,3 %).





invest in Albania

